



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 25

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 26 shkurt 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 21/2018 datë 22.2.2018	Për caktimin e përbërjes së nënkomisionit të përhershëm parlamentar, “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas”..... 1965
Vendim i Kuvendit nr. 22/2018 datë 22.2.2018	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 1965
Dekret i Presidentit nr. 10731, datë 22.2.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 1965
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 3, datë 14.2.2018	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2019..... 1966
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 4, datë 16.2.2018	Për zbatimin e programit të shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore CEEPUS III në Republikën e Shqipërisë..... 1967
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 5, datë 19.2.2018	Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë..... 1971
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 96, datë 23.1.2018	Për miratimin e kushteve të përgjithshme për akses në rrjetet e gazsjellësve të veprimtarive të kërkim-prodhimit..... 1973
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 30, datë 9.2.2018	Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në marrëveshjen për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike..... 1977

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 31, datë 9.2.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror.....	1979
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 32, datë 9.2.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AGE Sunpower” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas), me fuqi të instaluar 1998 kw.....	1979
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 33, datë 9.2.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas), me fuqi të instaluar 2000 kw.....	1980
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 34, datë 9.2.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kryezi”, me fuqi të instaluar 1990 kw.....	1981
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 35, datë 9.2.2018	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., për vendosjen e hipotekës mbi asetet që disponon, në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.....	1982
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 36, datë 9.2.2018	Mbi fillimin e procedurave për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “HEC Dunicë”, me nr. 123 , seria PV11K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 10.3.2011.....	1984
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 37, datë 9.2.2018	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “HEC Dunicë”, me nr. 124, seria T11P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011.....	1985
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3521/3, datë 20.2.2018	Për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen “Çlirimi”, Lushnjë”.....	1986
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasës Meri Musabelliu.....	1986
	Ndreqje gabimi material në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 72, datë 7.2.2018, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 16, datë 9.2.2018.....	1986
	Korrigjim gabimi material në vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 36, datë 6.3.2017, “Për licencimin e shoqërisë “ENPI Energi” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 56, datë 23.3. 2017.....	1986

**VENDIM
Nr. 21/2018****PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË
NËNKOMISIONIT TË PËRHERSHËM
PARLAMENTAR, “PËR BARAZINË
GJINORE DHE PARANDALIMIN E
DHUNËS NDAJ GRUAS”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, 22 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Përbërja e nënkomisionit të përhershëm, “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas” është si më poshtë:

- | | | |
|-----------------------|------------------|-------|
| 1. Eglantina Gjermani | kryetare | (PS) |
| 2. Orjola Pampuri | zëvendëskryetare | (PD) |
| 3. Elona Hoxha | anëtare | (PS) |
| 4. Klodiana Spahiu | anëtare | (PS) |
| 5. Musa Ulqini | anëtar | (PS) |
| 6. Antoneta Dhima | anëtare | (PS) |
| 7. Floida Kërpaçi | anëtare | (LSI) |
| 8. Rudina Hajdari | anëtare | (PD) |
| 9. Fatbardha Kadiu | anëtare | (PD) |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 22.2.2018

**VENDIM
Nr. 22/2018****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 86/2017 “PËR
CAKTIMIN E KRYESIVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në pikën I të vendimit të Kuvendit nr. 86/2017 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Enkelejd Alibeaj (PD) caktohet zëvendëskryetar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 22.2.2018

**DEKRET
Nr. 10731, datë 22.2.2018****PËR DHËNIE TË SHKETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Besnik Durak Fandaj
2. Arineta Xhafer Mulaj (Mula)
3. Flutura (Flutra) Skender Ibrahim

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**UDHËZIM****Nr. 3, datë 14.2.2018**

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E PROVIMEVE KOMBËTARE TË
MATURËS SHTETËRORE 2019**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2019 për shkollat e arsimit të mesëm të lartë të jenë:

a) Provime të detyruara: gjuhë shqipe dhe letërsi; matematikë dhe gjuhë e huaj;

b) Një provim me zgjedhje.

1.1 Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën, e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë, trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm të lartë.

1.2 Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z.

Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018) që kanë rezultuar jokalues në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë (të maturave shtetërore para vitit 2014) që aplikojnë me A1Z, nuk do ta japin provimin e detyruar D3.

2. Provimi me zgjedhje

2.1 Lista e lëndëve të provimit me zgjedhje të jetë:

Nr.	Shkollat e arsimit të mesëm të lartë
	Lënda
1	Kimi
2	Fizikë
3	Biologji
4	Histori
5	Gjeografi
6	Qytetari dhe psikologji
7	Filozofi dhe sociologji
8	Ekonomi

2.2 Provimet e detyruara të mbështeten vetëm në kurrikulën bërthamë. Programet orientuese të provimeve të detyruara (gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj e parë) për të gjithë maturantët/kandidatët të jenë në përshtatje me programet ekzistuese të arsimit të mesëm të lartë.

2.3 Programet orientuese të lëndëve me zgjedhje janë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z.

2.4 Programi orientues i lëndëve me zgjedhje përmban programin e lëndës bërthamë dhe atë me zgjedhje.

2.5 Maturanti/kandidati zgjedh një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse e ka zhvilluar ose jo apo i është ofruar ose jo ajo lëndë nga shkolla.

3. Kandidatit që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50 (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t'i japë më.

4. Kandidati, i cili rezulton mbetës në të paktën njërin prej provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore, duhet ta rijapë atë që të pajiset me diplomë.

5. Kandidatët që, në maturat shtetërore 2013–2018, kanë zgjedhur për të dhënë 2 (dy) provime me zgjedhje dhe:

a) kanë mbetur në të dy provimet, të japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi;

b) rezultojnë kalues në një prej tyre, të pajisen me diplomën e maturës.

6. Kandidatët që në Maturën Shtetërore 2012 kanë zgjedhur për të dhënë 3 (tri) provime me zgjedhje dhe:

a) kanë mbetur në dy ose në tri provime, të japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi;

b) rezultojnë kalues në dy prej tyre, të pajisen me diplomën e maturës.

7. Kandidatët të cilët kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime në institucionet e arsimit të lartë, t'u njihen provimet e detyruara dhe me zgjedhje ose provimet e njëvlershme me to, të njësuara nga njësitë arsimore vendore. Këta kandidatë, në rastet kur nuk kanë dhënë provime me zgjedhje ose i kanë dhënë dhe nuk kanë rezultuar kalues, kanë të drejtë të japin një



provim me zgjedhje kur e kanë të nevojshme për plotësimin e kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i MASR-së, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 4, datë 16.2.2018

**PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË
SHKËMBIMIT TË STUDIMEVE
UNIVERSITARE NË EVROPËN
QENDRORE CEEPUS III NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 25/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore (CEEPUS III); të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 357, datë 8.8.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin e studentëve të huaj universitarë e pasuniversitarë, pedagogëve të huaj që studiojnë apo ushtrojnë aktivitet akademik, sipas marrëveshjeve reciproke në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit”; si dhe të vendimit nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për

përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet e studimit në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Programi CEEPUS III mbështet bashkëpunimin ndëruniversitar në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, shkëmbimin e studentëve, të stafit akademik dhe kërkuesve shkencorë ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë pjesëmarrëse të vendeve anëtare në këtë program.

2. Bursat CEEPUS III janë bursa “të plota”, të cilat mbulojnë shpenzimet e jetesës, tarifat universitare për të cilat nuk është parashikuar përjashtimi i tyre në marrëveshje, akomodimin dhe sigurimin shëndetësor bazë, kur kjo zbatohet në vendin pritës. Bursat CEEPUS III janë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me koston e jetesës në vendin pritës.

3. Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), në përputhje me ligjin nr. 25/2016, “Për ratifikimin e Marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore (CEEPUS III)” dhe në bazë të fondeve buxhetore në dispozicion, i njofton/i garanton Komitetit të Përbashkët të Ministrave CEEPUS kuotat e saj për çdo vit të ardhshëm akademik. MASR-ja i transferon Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) fondet përkatëse për programin CEEPUS, në përputhje me kuotat e parashikuara për të cilat është njoftuar Komiteti i Përbashkët i Ministrave CEEPUS.

4. Bazuar në pikën 3, të nenit 4, të ligjit 25/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ngarkon Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) me zbatimin e programit CEEPUS III në Shqipëri, e cila do të luajë rolin e Zyrës Kombëtare CEEPUS (ZKC) dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) të promovojë programin CEEPUS, të informojë institucionet e arsimit të lartë (IAL) dhe të këshillojë të gjithë të interesuarit mbi



programin, në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Qendrore CEEPUS dhe zyrat kombëtare CEEPUS të vendeve anëtare;

b) të ndihmojë IAL-të dhe studentët gjatë aplikimit *online*, duke ofruar informacion dhe këshillim mbi mënyrën dhe procedurat e aplikimit, si për anëtarësim në një rrjet CEEPUS, ashtu dhe për shkëmbime individuale;

c) të caktojë një punonjës të agjencisë, si pikë kontakti për programin (*National CEEPUS Office*), i ngarkuar me administrimin *online* të programit CEEPUS; në përputhje me vendimin unanim të Komitetit të Përbashkët të Ministrave CEEPUS, zyrtar i lartë i programit CEEPUS (*Senior Official*) caktohet një nëpunës i nivelit të lartë, i autorizuar nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, rast pas rasti, për të kryer funksionet e zyrtarit të lartë të programit CEEPUS;

d) ZKC-ja të miratojë apo të refuzojë aplikimet për rrjet apo/ose anëtarësim në rrjet bazuar në sistemin e përbashkët të vlerësimit *online* CEEPUS;

e) në bashkëpunim me koordinаторët e departamenteve/fakulteteve/IAL-ve shqiptare, anëtare në rrjetet CEEPUS, ZKC-ja të vlerësojë, të pranojë, të miratojë dhe/ose të refuzojë aplikimet *online* për shkëmbime (mobilitete) nga studentë, pedagogë, studentë të diplomuar që aplikojnë për trajnim praktik në ndërmarrje tregtare, mjedise kërkimore ose në institucione qeveritare në Shqipëri, studentë për studime të rregullta semestrale, studentë të regjistruar/të pranuar në një institucion të arsimit të lartë anëtar në rrjetet CEEPUS III, edhe për ata të cilët janë pranuar nga fakultete/departamente jashtë rrjeteve CEEPUS III (*Freemovers*). Në aplikimet për mobilitete duhen vlerësuar fushat prioritare të shkencës të miratuara nga qeveria shqiptare, fushat e studimit dhe motivimi i kandidatit, bashkëpunimi i deritanishëm me fakultetin/departamentin pritës etj.;

f) çdo institucion i arsimit të lartë, fakultet, departament i IAL-ve shqiptare që merr pjesë në një apo disa rrjete CEEPUS, duhet të përcaktojë një koordinator për programin CEEPUS dhe t'ia njoftojë atë AKKSHI-së/ZK CEEPUS, e cila krijon bazën e të dhënave me koordinatorët CEEPUS në IAL; çdo koordinator CEEPUS në institucionin e arsimit të lartë, fakultet apo departament, duhet të ndihmojë studentët dhe

pedagogët e huaj që pranohen në kuadër të programit CEEPUS, gjatë qëndrimit në Shqipëri për detaje teknike/logjistike që mund të lindë nevoja;

g) t'i paguajë bursat CEEPUS kandidatëve të përzgjedhur fitues; AKKSHI u paguan studentëve fitues të bursës CEEPUS shpenzimet e fjetjes deri në 5.000 (pesë mijë) lekë në muaj, në rastet kur ata nuk akomodohen në mjediset e shoqërisë së trajtimit të studentëve sh.a., sipas kohës së përcaktuar në bursën e miratuar, bazuar në tarifat e vendosura nga Këshilli Mbikëqyrës i Ndërmarrjes së Trajtimit Studentor; për stafin akademik të listuar në shtojcën bashkëlidhur, shpenzimet e akomodimit përfshihen në bursën e miratuar; studentët dhe pedagogët fitues të bursave CEEPUS, në rastet kur ata nuk akomodohen në mjediset e ndërmarrjes së trajtimit studentor sh.a., duhet të kujdesen vetë për gjetjen e vendit të akomodimit, kur është e nevojshme edhe me ndihmën e koordinatorit të institucionit të arsimit të lartë/fakultetit pritës në Shqipëri; në përputhje me ligjin nr. 25/2016 të sipërcituar, programit të punës CEEPUS III dhe rregullave të procedurës CEEPUS, si dhe legjislacionit shqiptar në fuqi për veprimet financiare, AKKSHI duhet t'ia paguajë bursën CEEPUS kandidatit të pranuar, duke përdorur mënyra sa më lehtësuese për pedagogët dhe studentët e huaj.

h) të sigurojë që kandidatët, të cilët kanë përfutur bursa CEEPUS III, të plotësojnë *online* raportimin, siç është vendosur njëzëri nga Komiteti i Përbashkët i Ministrave CEEPUS;

i) bazuar në thirrjen e Zyrës Qendrore CEEPUS, të kryejë njëherë në vit *online* përcaktimin e IAL-ve shqiptare publike dhe jopublike që kanë të drejtë të përzgjidhen (*eligible institutions*) në programin CEEPUS III, pas këshillimit përkatës në formë elektronike me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; ndryshime në listën e IAL-ve, që mund të përzgjidhen, nuk mund të bëhen gjatë vitit akademik;

j) gjatë mbledhjes së Komisionit Ndërkombëtar (*International Commission*), Zyra Kombëtare CEEPUS (ZKC) kryen *online* shpërndarjen e bursave, sipas kërkesave të rrjeteve pjesëmarrëse; pas kësaj, ZKC-ja njofton të gjitha IAL-të shqiptare publike ose jopublike pjesëmarrëse në rrjetet CEEPUS III, për kuotat e përcaktuara për secilin prej tyre;



k) të kontraktojë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, ekspertë të jashtëm për vlerësimin e programit, të bashkërendojë punën me ta e të njoftojë MASR-në për rezultatet e vlerësimit të tyre;

l) të marrë pjesë aktive në mbledhjet që organizohen nga Zyra Qendrore CEEPUS dhe të zbatojë vendimet që merren në to;

m) të ndihmojë në pjesëmarrjen e ministrit apo të përfaqësuesve të ministrisë të autorizuar prej tij, në takimet e Komitetit të Përbashkët të Ministrave CEEPUS dhe mbledhjet e tjera që organizohen për mbarëvajtjen e këtij programi;

n) të kryejë vlerësimin kombëtar të programit dhe të ndihmojë në vlerësimin e përgjithshëm të tij, sipas rastit dhe sipas kërkesës së Zyrës Qendrore CEEPUS;

o) të hartojë raportin vjetor mbi zbatimin e programit CEEPUS në Shqipëri dhe t’ia paraqesë atë MASR-së.

5. Tarifat për çdo kategori përcaktohen në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

a) Nëse kuotat e parashikuara për shkëmbimet e studentëve dhe të stafit akademik nuk janë shpenzuar, ato mund të përdoren edhe për bursat *freemovers* (aplikime jashtë rrjeteve CEEPUS). Miratimi i bursave *freemovers* bëhet mbi të njëjtat kritere si për bursat e zakonshme CEEPUS, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi.

b) Fondet e miratuara për një vit akademik, të pashpenzuara apo të kursyera në fund të vitit

financiar/akademik, bazuar në ligjin 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, transferohen për vitin e ardhshëm financiar/akademik për të njëjtin qëllim.

c) Bazuar në nenin 1, pikën 7, të ligjit 25/2016, fondet CEEPUS të pashpenzuara gjatë një viti akademik mund të përdoren edhe për takimet koordinuese ndërmjet rrjeteve.

6. Udhëzimi nr. 13, datë 15.4.2010, i MASH-së, “Për zbatimin e programit për mbështetjen e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë, në kuadër të programit të shkëmbimeve të studimeve universitare për Evropën Qendrore CEEPUS II, për vitin akademik 2009–2010”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Integritetit Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MASR, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla



SHTOJCA 1

Kategoria	Bursa/paga mujore	Të tjera
Studentë dhe studentë të diplomuar në institucione të arsimit të lartë në sport	9.410 lekë/muaj	Bursa për studentët parashikon ushqimin dhe sigurimin shëndetësor bazë. Për shpenzimet e fjetjes, studentëve u ofrohet maksimumi 5.000 (pesë mijë) lekë në muaj, sipas tarifave të vendosura nga Këshilli Mbikëqyrës i Ndërmarrjes së Trajtimit Studentor, në rastet kur ata nuk akomodohen në mjediset e shoqërisë së trajtimit të studentëve sh.a. Hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjutera ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës.
Studentë dhe studentë të diplomuar në institucione të tjera të arsimit të lartë	8.900 lekë/muaj	Bursa për studentët parashikon ushqimin dhe sigurimin shëndetësor bazë. Për shpenzimet e fjetjes studentëve u ofrohet maksimumi 5.000 (pesë mijë) lekë në muaj, në rastet kur ata nuk akomodohen në mjediset e shoqërisë së trajtimit të studentëve sh.a., sipas tarifave të vendosura nga Këshilli Mbikëqyrës i Ndërmarrjes së Trajtimit Studentor. Hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjutera ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës.
Profesor	121.000 lekë/muaj	Qëndrimi, fjetja dhe sigurimi shëndetësor bazë përfshihet në pagën e parashikuar; hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjutera ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës.
Profesor i asociuar	105.200 lekë/muaj	Qëndrimi, fjetja dhe sigurimi shëndetësor bazë përfshihet në pagën e parashikuar; hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjutera ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës.
Docent (doktor)	95.800 lekë/muaj	Qëndrimi, fjetja dhe sigurimi shëndetësor bazë përfshihet në pagën e parashikuar; hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjutera ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës.
Docent (master)	91.800 lekë/muaj	Qëndrimi, fjetja dhe sigurimi shëndetësor bazë përfshihet në pagën e parashikuar; hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjutera ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës.
Lektor i parë/kërkues i parë	90.300 lekë/muaj	Qëndrimi, fjetja dhe sigurimi shëndetësor bazë përfshihet në pagën e parashikuar; hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjutera ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës.
Lektor/kërkues	73.400 lekë/muaj	Qëndrimi, fjetja dhe sigurimi shëndetësor bazë përfshihet në pagën e parashikuar; hyrje e lirë në laboratorë, biblioteka, kompjutera ofrohet nga institucioni i arsimit të lartë pritës.

Shënim. Tarifat sipas kategorive indeksohen sipas ndryshimeve që pësojnë vendimet e Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve” apo “Për bursat e studimit”.

**UDHËZIM****Nr. 5, datë 19.2.2018****PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE
PËRBËRËSE TË RAPORTIMIT VJETOR
DHE AFATIT PËR RAPORTIM TË
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË
LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 32, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

UDHËZON:

1. Për çdo vit akademik, institucionet e arsimit të lartë (IAL) paraqesin pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, raportet vjetore për veprimtarinë e kryer.

2. Raportimi synon:

a) të paraqesë informacione të qarta dhe transparente të veprimtarisë së IAL-së në zbatim të misionit të tyre, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

b) të ofrojë informacion për ministrinë mbi gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim, për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që ato ofrojnë, si dhe elemente të tjera që lidhen me shërbimet që IAL-ja ofron;

c) të nxitë dhe të rritë përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe sigurinë e cilësisë së shërbimeve që ofron IAL-ja;

d) të paraqesë problemet e konstatuara nga IAL-ja, me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat shtetërore në fushën e arsimit.

3. Raporti vjetor hartohet nga IAL-ja në 1 (një) kopje origjinale në formë të shkruar dhe/ose elektronike dhe i dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda muajit shtator të çdo viti. Raporti vjetor mund të dorëzohet edhe në formë elektronike, sipas rastit, i skanuar në formatin PDF.

4. Raporti vjetor përgatitet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit i institucionit të arsimit të lartë, i strukturuar sipas fushës së tyre të kompetencës ku trajtohen çështjet si më poshtë:

A. Senati Akademik:

a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.

b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.

c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:

i) politikat e kërkimit shkencor;

ii) të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;

iii) produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;

iv) të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.

d) Të dhëna mbi programet e studimit.

i) IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar.

ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.



iii) IAL-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme të programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.

e) Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

f) Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik.

g) Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar:

i) përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar;

ii) përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.

h) Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

i) Vlerësime të IAL-së dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe një përshkrim të ndërveprimit të IAL-së me strukturat e varësisë të ministrisë, duke përfshirë edhe:

i) një vlerësim të përgjithshëm të komunikimit me ministrinë dhe institucionet në varësi të saj, duke theksuar mbi përmirësimet e mundshme në këtë komunikim;

ii) vlerësime dhe rekomandime për ndryshime të sistemit apo akteve ligjore e nënligjore në fuqi që ndikojnë në veprimtarinë e IAL-së, të shoqëruar me arsyetime të hollësishme.

j) Të dhëna mbi studentët si:

i) numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;

ii) numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioriteteve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore.

iii) numrin e studentëve të shkëlqyer;

iv) numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;

v) numrin e studentëve që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit;

vi) pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre;

vii) përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen;

viii) një vlerësim të përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi;

B. Bordi i Administrimit:

a) Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.

b) Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit.

c) Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.

d) Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore;

e) Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.

f) Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, në bashkëpunim me Senatën Akademik të institucionit të arsimit të lartë.

Të dhënat e mësipërme miratohen në mbledhje të përbashkët të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit të institucionit të arsimit të lartë dhe i dërgohen Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me një raport të përbashkët.



5. Në rastet kur IAL-ja nuk e dorëzon raportin vjetor, brenda afatit kohor të caktuar në këtë udhëzim, pa arsye të përligjura, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë kërkon marrjen e masave administrative nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Në rastet kur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë konstaton pavërtetësi në të dhënat e paraqitura të raportit vjetor nga IAL-të, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, vendos kushte ndaj IAL-së dhe/ose pezullon veprimtarinë e IAL-së, në rast se veprimi apo mosveprimi nuk përbën vepër penale.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në MASR dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

URDHËR
Nr. 96, datë 23.1.2018

**PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË
PËRGJITHSHME PËR AKSES NË
RRJETET E GAZSJELLËSVE TË
VEPRIMTARIVE TË KËRKIM-
PRODHIMIT**

Në përputhje me pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 116, të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2016, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe të pikës 3/“a”, të nenit 5, të ligjit nr. 7746, datë 28.7.2016, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kushtet e përgjithshme për akses në rrjetet e tubacionit të kërkim-prodhimit (këtu e më poshtë, “Kushtet e përgjithshme”) do të përcaktojnë kërkesat, masat dhe procedurat e zbatueshme në lidhje me aksesin në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit ose të ndonjë pjese të tyre, duke përfshirë edhe objektet e furnizimit të shërbimeve teknike të rastit për një akses të tillë, për aq kohë sa këto kapacitete tubacionesh nuk përdoren nga

poseduesit e tyre për qëllim të transportimit të prodhimit të tyre, duke pasur në konsideratë parimet e transparencës e të mosdiskriminimit.

2. Kushtet e përgjithshme do të rregullojnë vetëm marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të gazit, duke përfshirë klientët dhe zotëruesit e gazsjellësit. Marrëdhëniet në lidhje me aksesin në tubacionet e naftës në aktivitetet e kërkim-prodhimit do të rregullohen sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 7746, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar dhe/ose aktet e tjera ligjore të aplikueshme.

3. Për qëllim të këtyre kushteve të përgjithshme, termat e mëposhtëm përdoren në kuptimin e përcaktuar në këtë akt:

3.1 “Kontrata e aksesit” do të thotë kontratë e lidhur ndërmjet zotëruesit të gazsjellësit dhe pjesëmarrësve të tregut të gazit për akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit.

3.2 “Akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit” do të thotë e drejtë e një pjesëmarrësi në tregun e gazit për të përdorur rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit ose ndonjë pjesë të tij, përfshirë edhe objektet që ofrojnë shërbime teknike të rastësishme në një akses të tillë, për transportin e gazit natyror ndërmjet objekteve të lidhura me tubacionin përkatës të kërkim-prodhimit ose ndonjë pjese të tij.

3.3 “Aplikues” është një pjesëmarrës në tregun e gazit që i kërkon zotëruesit të gazsjellësit të japë akses në rrjetin e tubacioneve të kërkim-prodhimit.

3.4. “Pjesëmarrës i tregut të gazit” nënkupton një subjekt që vepron në sistemin e gazit natyror, siç përcaktohet me ligjin nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, duke përfshirë edhe klientët.

3.5. “Zotëruesi i gazsjellësit/pronari i tubacionit” do të thotë një subjekt i cili zotëron ose, përndryshe, posedon rrjete të tubacionit të kërkim-prodhimit ose ndonjë pjesë të tyre dhe është përgjegjës për funksionimin e tij dhe, siç kërkohet nga aktet ligjore në fuqi, i autorizuar për veprimtari në tubacionet e kërkim-prodhimit në sektorin e hidrokarbureve.

4. Termat e tjerë që nuk përmenden në pikën 3 duhet të përdoren në kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”.



II. KËRKESAT PËR AKSES NË RRJETET E TUBACIONEVE TË KËRKIM-PRODHIMIT

1. Aksesit në rrjetet e tubacionit në kërkim-prodhim do të bazohet në kërkesat e mëposhtme për t'u zbatuar dhe realizohet në bazë të dhe në përputhje me këto kushte të përgjithshme:

1.1 Pjesëmarrësit e tregut të gazit, kudo që ndodhen, në rast të mungesës së kapaciteteve të transportimit, do të jenë në gjendje për të marrë akses në rrjetet e gazsjellësve të kërkim-prodhimit;

1.2 Zotëruesi i gazsjellësit garanton një akses të hapur në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit, nën funksionimin e tyre, në kuadër të kapacitetit që është ose mund të bëhet në mënyrë të arsyeshme në dispozicion;

1.3 Aksesit në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit jepet në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese, bazuar në procedura të qarta, transparente dhe të publikuara, si dhe organizohet ndër të tjera, duke marrë parasysh sigurinë dhe rregullsinë e furnizimeve të gazit natyror nga përdoruesit e tjerë të sistemit, përfshirë dhe mbrojtjen e mjedisit;

1.4 Aksesit në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit negociohet dhe jepet në bazë të kontratës së aksesit të rënë dakord reciprokisht ndërmjet palëve përkatëse kontraktuese;

1.5 Aksesit në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit është një veprimtari e parregulluar, por asnjë nga kërkesat e rregulluara ose kontraktuale, masat apo procedurat për akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit nuk do të lejojnë ndonjë kufizim mbi konkurrencën në tregun e gazit natyror ose për abuzim me pozitën dominuese.

2. Kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij kreut do të ndiqen në mënyrë të rregullt nga çdo zotërues gazsjellësi që vepron në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht vendit të themelimit të saj, statusin ligjor, strukturën aksionare dhe/ose të pronësisë.

III. KAPACITETI I DISPONUESHËM PËR AKSES NË RRJETIN E TUBACIONEVE TË KËRKIM-PRODHIMIT

1. Çdo zotërues i gazsjellësit do t'i dërgojë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet (më tej "ministria") të dhënat e mëposhtme:

1.1 Kapacitetin e përgjithshëm të rrjeteve të tubacioneve të kërkim-prodhimit që operohet prej tij; dhe

1.2 Kapacitetin në dispozicion për akses të negociuar në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit që do të llogaritet si kapacitet i mbetur i kapacitetit të përgjithshëm, siç përcaktohet në pikën 1.1 të këtij kreu, reduktuar nga:

1.2.1 Kapaciteti i pjesëve të rrjeteve të tubacioneve të kërkim-prodhimit dhe objektet të cilat përdoren për operacionet e prodhimit vendor në vendndodhjen (lokacionin) e vendburimit ku prodhohet gazit natyror;

1.2.2 Kapaciteti i rezervuar për nevojat e arsyeshme e të arsyetuara të zotëruetit të gazsjellësit për transportin apo përpunimin e gazit natyror;

1.2.3 Kapaciteti i rezervuar për nevoja të përpunimit të gazit natyror ose të naftës, ose objekteve të trajtimit të lidhur me tubacionin përkatës (përveç objekteve të tilla që operohen nga zotëruesi i gazsjellësit, siç referohet në paragrafin 1.2.2 të këtij kreu);

1.2.4 Kapaciteti i rezervuar, bazuar në kontratat e aksesit të lidhura para hyrjes në fuqi të këtyre kushteve të përgjithshme (në këtë rast, kontrata përkatëse, duhet të jetë kusht për ministrinë); dhe/ose

1.2.5 Kapaciteti i rezervuar si një masë për të siguruar sigurinë e furnizimit sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në aktet ligjore në fuqi.

2. Kapaciteti në dispozicion për akses të negociuar në rrjetin e tubacioneve të kërkim-prodhimit duhet të sigurohet në vlera ditore, të paktën për çdo tremujor kalendarik, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë më parë. Secili prej faktorëve që redukton një kapacitet të tillë, siç përmendet në nënpikat 1.2.1 dhe 1.2.5 të këtij kreu, duhet të identifikohet veçmas.

3. Së bashku me të dhënat e kërkuara sipas pikës 1 të këtij kreu, zotëruesi i gazsjellësit do t'i dërgojë ministrisë me një arsyetim të përshtatshëm, duke përfshirë analizat teknike dhe ekonomike, përkatëse në lidhje me këto. Ministria mund të kërkojë në çdo kohë informacione shtesë.

4. Ministria mund të kërkojë që zotëruesi i gazsjellësit mund të paraqesë korrigjime në lidhje me kapacitetin në dispozicion për aksesin e negociuar në rrjetin e tubacioneve të kërkim-prodhimit, në qoftë se të dhënat dhe/ose informacioni i dhënë nga zotëruesi i gazsjellësit nuk përputhen me kërkesat e përcaktuara në këto kushte të përgjithshme ose rezervimi i kapaciteteve të aplikuara nuk është justifikuar si duhet.



5. Pas konfirmimit paraprak nga ministria, zotëruesi i gazsjellësit do të publikojë në faqen e tij kapacitetin e përgjithshëm të rrjeteve të kërkim-prodhimit, nën operimin e tij dhe kapacitetin në dispozicion për akses të negociuar me to.

6. Të dhënat e kërkuara, sipas pikës 1 të këtij kreu, do të përditësohen, do t'i dërgohen ministrisë dhe do të publikohen në faqen e internetit të zotëruesit të tubacionit, sipas nevojës, por, në çdo rast, të paktën në respektim të kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu. Çdo ulje e kapacitetit në dispozicion për akses të negociuar në rrjetin e tubacioneve të kërkim-prodhimit, mund të shpallet dhe të zbatohet nga zotëruesi i gazsjellësit vetëm pas konfirmimit paraprak të ministrisë.

7. Kapacitetet e alokuara dhe të mbetura të rrjeteve të tubacioneve të kërkim-prodhimit, në kuadër të kapacitetit të disponueshëm për akses të negociuar do të publikohen dhe do të përditësohen rregullisht në faqen e internetit të zotëruesit të gazsjellësit të paktën në baza ditore.

IV. DHËNIA E AKSESIT NË TUBACIONIN E KËRKIM-PRODHIMIT

1. Aksesit në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit do të jepet nga zotëruesi i gazsjellësit, në bazë të parimit “vjen i pari, shërbehet i pari”, sipas kontratës së aksesit.

2. Çdo zotërues i gazsjellësit do të hartojë dhe do të miratojë kushtet e tij kryesore tregtare për akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit nën operimin e tij. Kur janë duke u zhvilluar kushte të tilla tregtare, zotëruesi i gazsjellësit do të konsultohet me pjesëmarrësit e tregut të gazit.

3. Kushtet kryesore tregtare do të përfshijnë *inter alia* specifikimet përkatëse teknike të rrjeteve të tubacioneve të kërkim-prodhimit ose ndonjë pjesë të tij, shërbimet e ofruara nga zotëruesi i gazsjellësit, shërbime teknike karakteristike për akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit dhe ofruesve të tyre, si dhe procedurat për alokimin e kapaciteteve dhe përfundimin e kontratës së aksesit.

4. Kushtet kryesore komerciale të miratuara do të publikohen në faqen e internetit të zotëruesit të gazsjellësit dhe do të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit e tregut të gazit, si një pjesë integrale e kontratës së aksesit.

5. Për atë sa termat dhe kushtet për akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit nuk janë rregulluar me këto kushte të përgjithshme, akte të

tjera ligjore në fuqi dhe kushtet kryesore tregtare të miratuara nga zotëruesi i gazsjellësit, ata do të negociohen dhe do të bihet dakord bashkërisht ndërmjet zotëruesit të gazsjellësit dhe aplikantit, duke përfshirë tarifat (çmimet) për shërbimet e ofruara nga zotëruesi i gazsjellësit.

6. Kërkesa për akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit duhet t'i dorëzohet zotëruesit të gazsjellësit nga aplikanti, në formë të shkruar ose elektronike (nëse kjo e fundit pranohet nga zotëruesi i gazsjellësit). Një kërkesë e tillë do të përbëhet prej informacionit të kërkuar nga zotëruesi i gazsjellësit, sipas kushteve kryesore tregtare, duke përfshirë kapacitetet totale, periudhën e alokimit të kapaciteteve dhe grafikun e preferuar të alokimit të kapaciteteve të kërkuar nga aplikanti.

7. Që nga momenti i marrjes së kërkesës, zotëruesi i gazsjellësit duhet të marrë parasysh kapacitetin e përgjithshëm të kërkuar nga aplikanti si të rezervuar përkohësisht dhe nuk do t'ua japë atë pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit. Zotëruesi i gazsjellësit dhe aplikuesi duhet të negociojnë termat dhe kushtet e mbetur për akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit, po ashtu edhe grafikun e saktë të alokimit të kapaciteteve, gjatë periudhës së përcaktuar në kushtet kryesore tregtare, e cila në çdo rast nuk duhet të jetë më e shkurtër se 3 (tri) ditë pune pas pranimit/marrjes të/së kërkesës nga zotëruesi i gazsjellësit. Zotëruesi i gazsjellësit dhe aplikanti janë të detyruar për të negociuar në mirëbesim.

8. Kapaciteti i rrjeteve të tubacioneve të kërkim-prodhimit do të konsiderohet si i ndarë për pjesëmarrësit e tregut të gazit dhe, për këtë arsye, do të jetë i garantuar plotësisht nga zotëruesi i gazsjellësit nga data e lidhjes së kontratës së aksesit.

9. Kapaciteti për akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit do të ndahet në bazë të kontratës së aksesit për periudhën, jo më të gjatë se një tremujor kalendarik, siç referohet në paragrafin 2, të kreut III, me përjashtim të rasteve kur zotëruesi i gazsjellësit ofron dhe publikon kapacitet ditore në dispozicion për qasje në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit, për një periudhë më të gjatë. Në çdo rast, ndarjet e kapaciteteve nuk duhet të tejkalojnë 12 (dymbëdhjetë) muaj rresht.

10. Transferimi i kapacitetit të ndarë për akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit, për të mirën e zotëruesit të gazsjellësit ose të një



pjesëmarrësi tjetër në tregun e gazit, do të lejohet pa asnjë kufizim nën iniciativën e një pjesëmarrësi në tregun e gazit, të cilit i është ndarë kapaciteti përkatës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kushtet kryesore tregtare.

V. REFUZIMI I AKSESIT NË RRJETET E GAZSJELLËSVE TË KËRKIM-PRODHIMIT

1. Zotëruesi i gazsjellësit do të ketë të drejtë të refuzojë aksesin në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit, siç kërkohet nga aplikuesi sipas kreut IV, vetëm në rastet kur:

1.1 Kapaciteti total i kërkuar nga kërkuesi është më i lartë se kapaciteti i mbetur në dispozicion për akses të negociuar të rrjeteve të tubacioneve të kërkim-prodhimit, i llogaritur sipas pikës 1.2 të kreut III, duke marrë parasysh alokimet e mëparshme për pjesëmarrësit e tjerë të tregut të gazit;

1.2 Zotëruesi i gazsjellësit dhe aplikanti nuk bien dakord për grafikun e alokimit/ndarjes të/së kapaciteteve apo termave dhe kushteve të nevojshëm për përfundimin e kontratës së aksesit për periudhën e përcaktuar në kushtet kryesore tregtare të tjera;

1.3 Aplikanti nuk pajtohet me kushtet kryesore tregtare;

1.4 Dhënia e aksesit në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit do të pengojë zotëruesin e gazsjellësit prej kryerjes së detyrimeve të shërbimit publik, të cilat i janë vendosur zotëruesit të gazsjellësit sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në aktet ligjore në fuqi; dhe/ose dhënia akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit do të rezultojë në papajtueshmëri të specifikimeve teknike, të cilat nuk mund të tejkalohen në mënyrë të arsyeshme;

1.5 Dhënia akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit do të rezultojë në vështirësi të cilat nuk mund të tejkalohen dhe do të mund të dëmtojnë prodhimin efikas, aktual dhe të planifikuar të hidrokarbureve; dhe/ose dhënia akses në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit është e kufizuar për shkak të masave të përkohshme mbrojtëse për sigurinë e furnizimit të ndërmarra në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

2. Çdo refuzim i aksesit në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit duhet të mbështetet në mënyrë të rregullt dhe të justifikuar nga zotëruesi i gazsjellësit dhe njoftimi përkatës, së bashku me arsyetimin përkatës, do t'i dërgohet pa asnjë vonesë

aplikantit dhe ministrisë. Ministria ka të drejtë të japë opinionin e saj dhe t'ia paraqesë atë zotëruesit të gazsjellësit dhe pjesëmarrësve përkatës të tregut të gazit, në rastet kur refuzimi i aksesit nuk konsiderohet i provuar si duhet. Mosmarrëveshjet që dalin nga refuzimi i aksesit do të zgjidhen në bazë të pikës 5, të kreut VI.

3. Zotëruesi i gazsjellësit që refuzon aksesin në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit, për arsye të mungesës së kapacitetit në dispozicion, do të bëjë përmirësime të nevojshme të rrjeteve të tubacionit të kërkim-prodhimit në përdorimin e tij, për aq sa është ekonomike për ta bërë këtë ose kur aplikanti është i gatshëm të paguajë për to.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pas hyrjes në fuqi të këtyre kushteve të përgjithshme, secili zotëruesi i gazsjellësit:

1.1 Do të dërgojë në ministri, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, të dhëna dhe informacionin e kërkuar sipas pikave 1 dhe 3, të kreut III;

1.2 Do të miratojë, jo më vonë se në 3 (tre) muaj, kushtet e saj kryesore tregtare sipas kreut IV;

1.3 Do të sigurojë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës që përcaktohet në pikën 1.2 si më sipër, zbatimin e plotë të këtyre kushteve të përgjithshme për dhënien e aksesit në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit.

2. Kur kërkohet konfirmim paraprak nga ministria sipas këtyre kushteve të përgjithshme, ministria do të kërkojë nga zotëruesi i gazsjellësit të dhëna dhe/ose informacione shtesë apo korrigjime të tyre ose do të nxjerrë një konfirmim të tillë jo më vonë se në 10 (dhjetë) ditë pune që pasojnë marrjen e të dhënave dhe/ose informacioneve nga zotëruesi përkatës i gazsjellësit. Në mungesë të një kërkesë apo konfirmimi nga ministria, brenda kësaj periudhe, ministria konsiderohet se nuk ka asnjë kundërshtim dhe konfirmimi do të pranohet si i mirëqenë.

3. Zbatimi i këtyre kushteve të përgjithshme monitorohet dhe mbikëqyret nga ministria.

4. Ministria njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për praktikën e zbatimit të këtyre kushteve të përgjithshme, duke përfshirë procedurat e aplikuara për akses dhe refuzim të aksesit dhe/ose çdo ndryshim të tij. Një njoftim i tillë dërgohet të paktën një herë në vit.

5. Ankesat dhe kundërshtimet që dalin nga këto kushte të përgjithshme të trajtohen dhe të zgjidhen nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni për



Mbrojtjen e Konsumatorëve, në kuadër të kompetencave të tyre përkatëse, të përcaktuara sipas akteve ligjore në fuqi. Autoritetet kompetente sigurojnë që mosmarrëveshjet në lidhje me aksesin në rrjetet e tubacioneve të kërkim-prodhimit janë vendosur në mënyrë efikase.

6. Personat, të cilët kryejnë shkelje të këtyre kushteve të përgjithshme, janë subjekt i sanksioneve, në bazë të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe/ose ligjet e tjera në fuqi që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e hidrokarbureve.

7. Ngarkohen Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit për përcjelljen e këtij urdhri pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

8. Ngarkohen Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, si dhe Albpetrol sh.a. për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjikhuri

VENDIM

Nr. 30, datë 9.2.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN PËR SHËRBIMIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE) SHA DHE FURNIZUESIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; të nenit 19, pika 2, të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së

energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2018, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 15.2.2017 ka miratuar marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike.

- Në datën 17.1.2018, në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë OSHEE sh.a. me nr. 975 prot., nëpërmjet së cilës OSHEE sh.a. kërkon nga ERE shqyrtimin dhe vendimmarrjen, në lidhje me disa propozime për ndryshime në këtë marrëveshje.

- Kërkesa drejtuar ERE-s nga OSHEE sh.a. është në përputhje me parashikimet e nenit 26, pika 1, të “Rregullores së organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, si dhe nenin 19, të “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a. për disa ndryshime në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017.

- Në nenin 8, pika 8.1, në fund të paragrafit, në lidhje me “Rregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, shtohet në fund, që do të hyjë në fuqi më 1 janar 2019.



- Në nenin 8, pika 8.3, propozohet të shtohet: Në të gjitha rastet e ndërprerjeve të paplanifikuara, me përjashtim të ndërprerjeve të shkaktuara ose rezultatit të ekzistencës së forcës madhore, si dhe ato të perkufizuara në nenin 11, pika 11.1, energjia e cila nominohet nga furnizuesi, por nuk shpërndahet nga OSHEE sh.a., për shkak të ndërprerjes, do të kompensohet nga OSHEE sh.a., si më poshtë vijon:

- Në nenin 11, pika 11.2, paragrafi i fundit, të ndryshohet afati nga 1 ditë në 6 ditë: OSHEE sh.a. do të njoftojë furnizuesin menjëherë pas marrjes dijeni për ngjarjen e ndërprerjes. OSHEE sh.a., brenda gjashtë ditëve pune, me anë të një akti teknik do të informojë zyrtarisht furnizuesin, në lidhje me rastin e ndërprerjes.

- Në nenin 12.2 është plotësuar duke u cituar se cilët do të konsiderohen palët: Në mënyrë që të lejohet furnizuesi të marrë masat e përshtatshme, OSHEE sh.a., në përputhje me programin vjetor të remonteve, të rakorduara mes palëve (OSHEE sh.a., OST sh.a., palë të treta të interesuara), do të informojë me shkrim furnizuesin, jo më vonë se 20 ditë para fillimit të muajit në të cilin parashikohet kryerja e punimeve të mirëmbajtjes, duke specifikuar zgjatjen e punimeve, objektin (vendin) ku do të kryhen këto punime, si dhe konsumatorët që parashikohet t'u ndërpritet furnizimi.

- Në nenin 12, pika 12.3, është propozuar ndryshimi i afatit të njoftimit, nga 5 ditë në 1 ditë: OSHEE sh.a., në raste të paparashikuara, me qëllim ruajtjen e sigurisë së rrjetit, ka të drejtë të reduktojë programin e shpërndarjes për një periudhë të caktuar kohore, duke njoftuar furnizuesin të paktën 1 (një) ditë pune në avancë, si dhe duke provuar që ndërprerja ishte e vetmja mënyrë për të mundësuar sigurinë e rrjetit.

- Në nenin 12.5 është shtuar: Është detyrë e furnizuesit të njoftojë konsumatorët me të cilët ka kontratë për ndërprerje të energjisë elektrike, si detyrë funksionale e tij.

- Në nenin 18.2, paragrafi i fundit, është ndryshuar afati i parashikuar për njoftimin nga “një ditë” përpara datës së furnizimit në “jo më pak se tri ditë pune”. Furnizuesi duhet të njoftojë OSHEE-në se ka lidhur kontratë të furnizimit me një klient të ri fundor, jo më pak se tri ditë pune përpara datës së furnizimit.

- Aneksi 2.1 propozohet të ndryshohet:

1. Identifikimi i palëve të kontraktuara: _____ sh.p.k. dhe KF:

2. Pikat e livrimit/tërheqjes:

3. Nënstacioni dhe/ose fidri:

4. Kodi i pikës së matjes në sistemin e OSHEE sh.a.:

5. Kohëzgjatja e kontratës (data e fillimit – data e përfundimit):

6. Data në të cilën bëhet efektive zgjidhja e kontratës:

7. Furnizuesi duhet të paraqesë dokumentacionin teknik si vijon:

- Territori gjeografik ku ushtron aktivitetin e furnizimit i paraqitur në GIS;

- Nënstacioni dhe/ose fidri ku do të livrohet energjia e siguruar nga furnizuesi e paraqitur në GIS;

- Skemat elektrike të nënstacioneve/fidrave/kabinave deri në klientin fundor të prezantuar në GIS;

- Lista e konsumatorëve të ndarë sipas kategorive: familjarë, privatë etj.;

- Kontratën e lidhur me konsumatorin, ku të jetë përfshirë siguria e punës së pajisjeve të konsumatorit përkundrejt sigurisë së punës së rrjetit elektrik.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a., si dhe palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 31, datë 9.2.2018****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
SIGURIMIN E AKSESIT TË PALËVE TË
TRETA NË SISTEMIN E
TRANSMETIMIT DHE
TRANSPARENCËN NË SEKTORIN E
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 42, pika 3 dhe të nenit 48, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016”, si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/01/PHLG-EnC, datë 12.1.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit, në bazë të nenit 42, pika 3 dhe nenit 48, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE miraton rregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror.

- “Draftrregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror” janë hartuar në përputhje me referencat në Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 32, datë 9.2.2018****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “AGE SUNPOWER” SHPK,
PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA IMPIANTI
FOTOVOLTAIK TOPOJË (SHEQ
MARINAS), ME FUQI
TË INSTALUAR 1998 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a”; të nenit 10, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “AGE Sunpower” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas), me fuqi të instaluar 1998 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 110 prot, datë 26.1.2018, shoqëria “Age Sunpower” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas).



- Në datën 12.10.2017 është lidhur kontrata me nr. 2272 rep. dhe 1051/3 kol., “Për ndërtimin shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik “Topojë”, me kapacitet të instaluar 1998 kw; në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe mbajtësit të miratimit përfundimtar, shoqërisë “AGE Sunpower” sh.p.k.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me miratimin përfundimtar nr. 5789/2, datë 11.9.2017, ka miratuar ndërtimin e Centralit Fotovoltaik Topojë, në favor të “AGE Sunpower” sh.p.k., me fuqi të instaluar 1998 kw, në koordinatat e përcaktuara në nenin 3 të kontratës së sipërcituar.

- Aplikimi i shoqërisë “AGE Sunpower” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3 (germat “a”, “c”, “d”), 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë);

- Nenin 9, pika 4.4.3, germa “b” (dokumentacioni teknik dhe grafik), do të njoftohet subjekti që t'i plotësojë ato brenda afateve që përcakton “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AGE Sunpower” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas) me fuqi të instaluar 1998 kw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 33, datë 9.2.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “SEMAN SUNPOWER”
SHPK, PËR LICENCIM NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
IMPIANTI FOTOVOLTAIK TOPOJË
(SHEQ MARINAS), ME FUQI
TË INSTALUAR 2000 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a”; të nenit 10, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 19, pika 1, germa “a”, e “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas), me fuqi të instaluar 2000 kw,



konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 109 prot, datë 26.1.2018, shoqëria “Seman Sunpower” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas).

- Në datën 29.12.2017, është lidhur kontrata me nr. 6299 rep. dhe 1598 kol., “Për ndërtimin shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik “Topojë”, me kapacitet të instaluar 2000 kw; në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të miratimit përfundimtar, shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me miratimin përfundimtar nr. 4115/3 prot., datë 28.12.2017, ka miratuar ndërtimin e Centralit Fotovoltaik “Topojë”, në favor të “Seman Sunpower” sh.p.k., me fuqi të instaluar 2000 kw, në koordinatat e përcaktuara në nenin 3 të kontratës së sipërcituar.

- Aplikimi i shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1 4.4.2, 4.4.3 (germat “a”, “c”, “d”), 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë);

- Nenin 9, pika 4.4.3, germa “b” (dokumentacioni teknik dhe grafik);

- Nenin 9, pika 4.4.5, gerrat “a” (miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në

rrjetin elektrik të transmetimit ose të shpërndarjes), do të njoftohet subjekti që t’i plotësojë ato brenda afateve që përcakton “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas), me fuqi të instaluar 2000 kw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 34, datë 9.2.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALESIO-2014” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KRYEZI”, ME FUQI TË INSTALUAR 1990 kw

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit



dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kryezi”, me fuqi të instaluar 1990 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 818 prot. të ERE-s, datë 26.12.2017, shoqëria “Alesio–2014” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kryezi”.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 38, pika 1, germa “a”, përcakton se: “Afati i vlefshmërisë së licencës, për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet.”.

- Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 13, datë 10.1.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kryezi”.

- Aplikimi i shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Alesio–2014” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kryezi”, me fuqi të instaluar 1990 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 35, datë 9.2.2018

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SHPK, PËR VENDOSJEN E HIPOTEKËS MBI ASETET QË DISPONON, NË FAVOR TË “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 104, pika 4, germa “a”; të neneve 113; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”; të pikës 1.3 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; të neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k. për miratimin e vendosjes së hipotekës mbi asetet që disponon, në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 88, datë 7.6.2017, miratoi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., për lënien peng të aseteve në favor të bankave: “Green For Growth Fund Southeast Europe S.A. (GGF)” dhe “Oesterreichische Entwicklungsbank AG (OeEB)”.

- Subjekti ka paraqitur kërkesën nr. 43 prot., datë 8.11.2017 dhe dokumentacionin shoqërues për vendosje të hipotekës mbi asetet e shoqërisë, në favor të “Intesa Sanpaolo Bank of Albania” sh.a., për efekt të livrimit të një kredie për ndërtimin e HEC “Lengarica”.



- Shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k. dhe banka “(GGF) Green For Growth Fund Southeast Europe” kanë rënë dakot që banka “Intesa Sanpaolo Bank of Albania” sh.a., të blejë kredinë e dhënë nga banka “(GGF) Green For Growth Fund Southeast Europe”, duke u bërë palë e re në financimin e projektit për ndërtimin e HEC “Lengarica”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 11, datë 10.1.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., për miratimin e vendosjes së hipotekës mbi asetet që disponon, në favor të “Intesa Sanpaolo Bank of Albania” sh.a.

- Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1 (germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI :

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., për vendosje të hipotekës mbi pasuritë që disponon, në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., sipas listës bashkëlidhur.

2. Shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 88, datë 7.6.2017, mbi “Miratimin e kërkesës së shoqërisë “2 Lengarica & Energy 2” sh.p.k., për lënien peng të aseteve në favor bankave: “Green For Growth Fund Southeast Europe S.A. (GGF) 2” dhe “Oesterreichische Entwicklungsbank AG (OeEB)””.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë të interesuarit lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit Ahmeti

ASETETET E SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SHPK, PËR TË CILAT BORDI I ERE-s KA DHËNË MIRATIMIN ME VENDIMIN NR. 35, DATË 9.2.2018, PËR VENDOSJEN PENG NË FAVOR TË “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA

- Një digë përfshi muret e krahut me përmasa 66x7 m të bëra prej betoni.

- Një rrjedhje me dimension kanali 2,50x20 m bërë nga betoni.

- Një derdhje baseni me përmasa 66x40 m e bërë prej betoni.

- Një shtrat lumi 70x7 m bërë nga betoni/guri.

- Një rrjedhje me përmasa 3,9x22 m të bërë nga betoni.

- Një dhomë ngushtimi, afërsisht 17 m të gjatë, të bërë prej betoni.

- Një kanalizim me ngushtim 3.0x25 m i bërë nga betoni.

- Një element i tejmbushjes përfshirë shfryrës disipativ me përmasa 14,5x7 m i bërë nga betoni.

- Një kanalizim i desanderit, afërsisht 30 m i gjatë, prej betoni.

- Një dhomë desander 42x15 m e bërë prej betoni.

- Një shpërndarës në dhomën e desanderit (pajisje kontrolli), afërsisht 20 m e gjatë, i bërë nga betoni; 3 kanalizime të daljes së ujit, afërsisht 12 m të gjata, të bëra prej betoni; fundi i kanalit të ujit me përmasa 50x3x50 m, i bërë nga betoni dhe kalimi i peshave, afërsisht 200 m i gjatë, i bërë prej betoni/guri.

- Sistemi i kalimit të ujit në turbinë 65x3,10 m bërë nga betoni dhe tuneli i kalimit të ujit në turbinë me përmasa 4000x3,2x4 m.

- Një dhomë *Forebay* me përmasa 25x9 m e bërë nga betoni.

- Seksioni DN 2400 i bërë nga sistemi i tubacionit GRP, afërsisht 1220 m GRP, beton, cilindra, 25 blloqe ankorimi të ndryshme prej betoni, një dhomë zbrazjeje, e bërë nga betoni, një dhomë ventilimi e bërë prej betoni.

- Seksioni DN 2200 i bërë nga sistemi i tubacionit GRP, afërsisht 1240 m GRP, beton, cilindra, 27 blloqe ankorimi të ndryshme prej betoni, një dhomë zbrazjeje e ndryshme prej betoni, një dhomë ventilimi prej betoni.



- Seksioni DN 2000 një sistem tubacioni GRP1, afërsisht 1220 m GRP, beton cilindra, 26 blloqe ankorimi të ndryshme prej betoni, një dhomë zbrazjeje prej betoni, dhoma e ventilimit prej betoni.

- Seksioni DN 2400 dhoma e zbrazjes dhe dhoma e ventilimit: Seksioni DN 2200 dhoma e zbrazjes dhe dhoma e ventilimit: Seksioni DN 2000 dhoma e zbrazjes dhe dhoma e ventilimit.

- Centrali elektrik i përbërë nga një strukturë e ndërtesës, me përmasa 27x12 m prej betoni, një kanal me çelik para digës, një strukturë e kanalit afërsisht 300 m cilindra.

- Nënstacioni 110 kV, Strukturat Civile (themelet) beton i ndryshëm.

- Digë ujëmbledhëse me gjerësi 100 m x 20 m trashësi prej betoni,

- Një desandër, 1300 m² total dhe gjatësi 96 m, mure të izoluar me perimetër 220 m, përfshirë edhe 6 porta hyrëse dhe 3 porta dalëse.

- Kanal ujëmbledhës me një gjatësi 100 m x 3, 7m gjerësi x 3,1 m thellësi, përfshirë aksesin në kanal prej 26 m.

- Tunnel me gjatësi totale 4000 m dhe pamje mesatare 11 m².

- Pellg ballor prej betoni rreth 150 m³, duke përfshirë një portë dalëse dhe një portë emergjente.

- Tubacion (GRP) me gjatësi 1220 m, me diametër 2,4 m; tubacion me gjatësi 1250 m, me diametër 2,2 m dhe një tubacion me gjatësi 1200 m, me diametër 2 m.

- Godinë centrale me sipërfaqe rreth 220 m², duke përfshirë të gjitha pajisjet elektrike dhe elektromekanike që përfshijnë: 2 turbina, 3 gjeneratorë, 2 valvola gj, një sistem që anashkalon me një valvol, kompartimentet e tensionit të lartë, tensionit të ulët dhe sistemin e kontrollit.

- Kanal uji me rreth 981 m gjatësi dhe 14 m gjerësi, bërë me beton.

- Lidhje në rrjet i përbërë nga 2 kabllot e energjisë, një transformator TM/TL 110 kV dhe një n/st. komutimi (vendi dhe zona do të përcaktohen gjatë punimeve).

VENDIM

Nr. 36, datë 9.2.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “HEC DUNICË”, ME NR. 123 , SERIA PV11K, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 27, DATË 10.3.2011

Në mbështetje të neneve 16; 42, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 18 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 5, gjerat “d” dhe “dh”; të nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e bordit nr. 54, datë 18.4.2017; pika 6, gjerat “d” dhe “dh”, të kushteve për “Licencën e prodhimit të energjisë elektrike”; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2018, pasi shqyrtoi, relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurave për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “HEC Dunicë”, me nr. 123, seria PV11K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 10.3.2011,

konstatoi se:

- Subjekti tregtar “HEC Dunicë” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 27, datë 10.3.2011, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, me licencë nr. 123, seria PV11K.

- Ky i licencuar ka paraqitur në ERE një kërkesë me nr. 08 prot., datë 19.1.2018, protokolluar me tonën me nr. 104 prot., datë 23.1.2018, për heqjen e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Trebinjë”, “Potgozhan 2”, “Kalivac”, “Dunicë 1”, “Dunicë 2”, si dhe heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017.



- MEI, me shkresën me nr. 46/49 prot., datë 26.4.2017, drejtuar shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k., për dijeni Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka njoftuar për zgjidhje të kontratës së koncesionit me nr. 2059 rep., dhe nr. 248/1 kol., datë 16.6.2009, për ndërtimin e hidrocentraleve në pellgun e lumit Dunicë, Pogradec. Kjo kontratë është lidhur midis bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Vortek” sh.p.k. dhe “By Best Duty Free” sh.p.k. dhe autoritetit Kontraktues ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k., me nr. 123, seria PV11K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 10.3.2011, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: “Trebinjë”, “Potgozhan 2”, “Kalivac”, “Dunicë 1”, “Dunicë 2”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “HEC Dunicë” sh.p.k. dhe MIE-n për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petril Ahmeti

VENDIM

Nr. 37, datë 9.2.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
HEQJEN E LICENCËS SË TREGTIMIT
TË ENERGISË ELEKTRIKE TË
SHOQËRISË “HEC DUNICË”, ME NR.
124, SERIA T11P, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 28,
DATË 10.3.2011.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “ç”, “d” dhe “dh” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”; të nenit 18, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e

licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 5, gerrat “d” dhe “dh”; të nenit 6 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e bordit nr. 54, datë 18.4.2017, pika 6.1, gerrat “d” dhe “dh” të kushteve të “Licencës së tregtimit të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016 dhe të nenit 19, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2018, pasi shqyrtoi, relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “HEC Dunicë”, me nr. 124, seria T11P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011,

konstatoi se:

- Subjekti tregtar “HEC Dunicë” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011, në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, me licencë nr. 124, seria T11P.

- Shoqëria tregtare “HEC Dunicë” sh.p.k. ka paraqitur në ERE kërkesën me nr. 08 prot., datë 19.1.2018, protokolluar me tonën nr. 104, datë 23.1.2018, për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, si dhe heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017.

- Referuar shkresave të komunikimit në vijim me MEI-n, me nr. 46/49 prot., datë 26.4.2017 dhe shkresën me nr. 46/51 prot., datë 14.6.2017, rezulton se subjekti deklaroi se është në kushtet e paaftësisë për të vazhduar aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe për rrjedhojë kërkon heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k., me nr. 124, seria T11P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011, për tregtimin e energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë shoqërinë “HEC Dunicë” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrir Ahmeti

KËRKESË

Nr. 3521/3, datë 20.2.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen “Çlirim”, Lushnjë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të

Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 203,381 (dyqind e tre mijë e treqind e tetëdhjetë e një) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE DHE VLERA E SHPRONËSIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT,
“SISTEMIMI I BLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN “ÇLIRIMI”, LUSHNJË”

Vlera e shpronësimit të z. Ibrahim Gega
Investitori: Bashkia Lushnjë

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja		Çmimi		Vlera totale		Vlera totale	Shënime konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
				Truall	Ndërtesë	Truall	Ndërtesë	Truall	Ndërtesë		
1	Ibrahim Gega	4/144	8571	3,8	3,8	9,707	166,494	36,886.60	166,494	203,381	Konfirmuar me shkresën e ZVRPP-së, me nr. 10,485 prot., datë 18.10.2017

Vlera totale e shpronësimit: 203,381

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 150, datë 17.1.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetases Meri Musabelliu, e datëlindjes 1.7.1984, si dhe caktimin e shtetases Engjellushe Musabelliu, si kujdestare për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të saj.

Ndreqje gabimi material

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 72, datë 7.2.2018, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018”, botuar në Fletoren

Zyrtare nr. 16, datë 9.2.2018, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Në fjalinë në fund të shkronjës “b”, të pikës 2.2, referenca nga “c” në “e” të zëvendësohet me nga “i-vi”.

Korrigjim gabimi material

Në vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 36, datë 6.3.2017, “Për licencimin e shoqërisë “ENPI Energji” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 56, datë 23.3.2017, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Kudo në vendim bëhet zëvendësimi i emërimit “ENPI Energji” sh.p.k. me “ENPI” sh.p.k.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë